

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga SCES Investment 17 S.à r.l., me seli të regjistruar në Place de la Gare 5, L-1616 Luksemburg, Luksemburg, dorëzuar nëpërmjet të autorizuarës Ljupka Noveska Andonova, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 12.02.2026, mori këtë:

### **AKTVENDIM**

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin SCES Investment 17 S.à r.l., me seli të regjistruar në Place de la Gare 5, L-1616 Luksemburg, Luksemburg, do të fitojë kontroll të vetëm mbi shoqërinë Swix Biopharma Holding AG, me seli të regjistruar në Neuhofstrasse 5A, 6340 Baar, Zvicër, edhe pse bën pjesë në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

### **Arsyetim**

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 22.01.2026, si dhe të plotësuar më datë 27.01.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftimi për përqendrim nga ana e SCES Investment 17 S.à r.l., me seli të regjistruar në Place de la Gare 5, L-1616 Luksemburg, Luksemburg, me të cilin SCES Investment 17 S.à r.l. do të fitojë kontroll të vetëm mbi shoqërinë Swix Biopharma Holding AG, me seli të regjistruar në Neuhofstrasse 5A, 6340 Baar, Zvicër, përmes shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me ekzaminimin e Njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcave të tyre, konstatoi si vijon:

#### **Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:**

**SCES Investment 17 S.à r.l.** është një shoqëri me qëllim të posaçëm (SPV), e themeluar ekskluzivisht për qëllimet e Transaksionit të Propozuar. Ajo nuk ka aktivitete të tjera afariste.

SCES Investment 17 S.à r.l. kontrollohet tërthorazi nga fonde të cilat menaxhohen dhe këshillohen nga shoqëritë e lidhura të SK Capital Partners L.P. („SK Capital“).

SK Capital është një shoqëri private investimesh me seli në SHBA, e fokusuar në sektorët e materialeve të specializuara, industrisë kimike dhe asaj farmaceutike. SK Capital është themeluar në vitin 2007 dhe e ka selinë në Nju Jork, SHBA, si dhe ka një zyrë në Majami, Florida, SHBA. Ajo është aktive në nivel global përmes shoqërive të saj të portofolit, me fokus të veçantë në Amerikën e Veriut, Zonën Ekonomike Evropiane (ZEE), Lindjen e Mesme dhe Australi.

Shoqëritë nga portofoli i SK Capital nuk kanë prani të regjistruar e as të hyra të realizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

**Swix Biopharma Holding AG** është aktive në komercializimin e produkteve të gatshme farmaceutike në formë dozimi për kompani farmaceutike të palëve të treta. Swix Biopharma Holding AG operon në disa shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore, Greqi, Eurazi dhe në disa ish-republika sovjetike, në Lindjen e Mesme dhe në Amerikën Latine. Kryesisht furnizon me produkte kompanitë biofarmaceutike, produktet që shiten pa recetë (OTC) dhe kompanitë e pajisjeve mjekësore në ato tregje.

Grupi Swix ka prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut përmes një shoqërie të varur:

AMIKUS FARMA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 62, lamela C, Shkup – Karposh. Veprimtaria prioritare e regjistruar e Amikus NMK është 73.11 – Agjenci reklamash.

Në Maqedoninë e Veriut, Swix Biopharma Holding AG është aktive në shitjen e produkteve farmaceutike në formë dozimi, në fushat e onkologjisë, sëmundjeve kardiovaskulare, sëmundjeve të rralla, endokrinologjisë, vaksinave, dermatologjisë, sistemit nervor qendror, osteoporozës, mjeteve anti-infektive, hematologjisë, gastroenterologjisë dhe transplantologjisë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

### **Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**KRYETARE**

**Mr. Малинка Силјановска Николиќ**